

**AKT - THEMELIMI  
I SHOQERISE « LA MER » shpk**

Në Tiranë, sot më datë 25/02/2022, janë të pranishëm shtetasit:

**1.KLODIANA MORINA** , atësia Esat , e datelindjes 15.12.1979, lindur në Tirane Shqipëri, dhe banuese ne Tirane , mbajtëse e ID H96215047J;

**2-EDA DOKU** atësia Vilson e datëlindjes 25.12.1988,lindur në Vore dhe banuese në Tirane Shqipëri, mbajtës i ID .I86225070B .

të cilët, në cilësinë e "Ortakëve Themelues", redaktuan këtë Akt themelimi , nëpërmjet të cilit ata deklaruan se me vullnet të lire të plotë dhe iniciativën e lire private, mbështetur ne Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil, Ligjin 9901 datë 14.04.2008, " Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Ligjin Nr. 131/ 2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit (Q.K.B.)", si dhe ndryshimet përkatëse, Si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore e fuqi, krijojnë/themelojnë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin "**LA MER**"

**KREU I**

**Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti**

**Neni 1**

**Emërtimi**


Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "LA MER".

**Neni 2**

**Forma Juridike**

Shoqëria "**LA MER** " është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personat fizikë të sipërpërmendur, të cilët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.



Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota.

### **Neni 3**

#### ***Selia***

Selia e shoqërisë, me seli në Tiranë, Rruga "Margarita Tutulani " nr. pasurise 7/248+1-N17 .

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra, përfaqësi, dege, filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

### **Neni 4**

#### ***Objekti i aktivitetit të shoqërisë***

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është në fushën si vijon:

Investimi në ndertim, investim në objekte ndertimi. Importimi, tregtimi dhe mbështetja teknike të mallrave ushqimore. Marja dhe menaxhimi i lokaleve, restoranteve, diskotekave. Marja në menaxhim dhe zhvillimi i ambjenteve të plazhit. Ndermjetesim i çdo lloji kategorie të pasurive të patundshme, vleresimi i pasurive të patundshme, angazhim në shitjen dhe dhenien me qira të çdo lloji pasurie të patundshme. Hapjen e zyrave dhe degeve të tjera të pasurive të patundshme për arritjen e qëllimit të subjektit.

Menaxhim dhe administrim  
pronash dhe objektësh.

### **Neni 5**

#### ***Kohëzgjata***

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

### ***KREU II***

#### ***KAPITALI***

### **Neni 6**

#### ***Kapitali themeltar***

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Lekë i përbërë nga gjithsej 2 kuota.

Kapitali themeltar është nënshkruar dhe i ndarë nga 2 ortakët e shoqërisë si vijon:

- **Klodiana Morina** zotërues i 1 kuote, që përbën 50% të kapitalit në vlerën 50.000 Lekë.
- **Eda Doku** zotërues i 1 kuote, që përbën 50% të kapitalit në vlerën 50.000 lekë.

## **Neni 7**

### ***Transferimi i kapitalit***

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;

dh) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga transferimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotës, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie

## **NENI 8 .Administrimi**

Shoqëria do të administrohet nga 1 administrator.

Administrator I shoqërisë është zgjedhur **Z. Arlind Cali ,mbajtes I kartes se identitetit J11130062Q**, të cilët do të ushtrjnë funksionet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

Administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Emertimi / shkarkimi i Administratorit behet nga Ortaket e shoqterise me vote unanime.

**NENI 9 ;**

### **SIGURIMI I PASURISE SE SHOQERISE**

9/1 Pasuria e shoqerise do te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve te Republikes si dhe ne institute te tjera private ekzistuese apo qe do te krijohen ne te ardhmen sipas legjislacionit ne fuqi .

9/2 Masa e pasurise qe do te sigurohet si dhe koha e sigurimit te saj do te vendoset nga Administatori .

**Neni 10**

### **MBYLLJA EKONOMIKE VJETORE E SHOQERISE**

Si rregull, veprimet ekonomike të shoqërisë do të mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Përfundim nga ky rregull do të bëhet kur e kërkon organi kompetent ligjor.

**Neni 11**

### **LIKUJDIMI I SHOQERISE**

Shoqëria do të shpërbëhet sipas rasteve që do të përcaktohen në statutin e saj.

**NENI 12**

### ***Baza Ligjore***

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe

Shoqëritë tregtare" të ndryshuar, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 13**

### ***Mosmarrëveshjet***

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.



## Neni 14


### **Dispozita përfundimtare**

Ky Akt themelimi , u redaktua në 4 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre origjinale.

### **ORTAKET**

1. Klodiana Morina

Klodiana Morina



2. Eda Doku

Eda Doku

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER SONILA A. XUKTHI



DATE 25/02/2022  
NR REP 372

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, para meje Notere SONILA A. XUKTHI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, EMIN DURAKU, NR.52, NR.1, NR.4, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES:**Eda Doku, atësia Vilson, amësia Bedrije, shtetas Shqiptar, lindur në Vorë, Tiranë dhe banues në Vorë, me adresë Rruga ' Muçaj '; Nd. Nd.75; H. Hyrja 1; Ap. Banesë Private; Vorë; F/Vorë; 1032; Vorë, lindur më 25/12/1988, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033875422 dhe nr. personal I86225070B , .

**NËNSHKRUES:**Klodiana Morina, atësia Esat, amësia Vera, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Blv. Zogu 1; Nd. 6; H. 1; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 15/12/1979, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037594029 dhe nr. personal H96215047J , .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, “Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise "La Mer", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE  
Sonila A. Xukthi